
AKT THEMELIMI

“UDV group ” SHPK

1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë

Emri i shoqërisë do të jetë “UDV group” SHPK, nga këtu e më poshtë referuar edhe si “shoqëria”, e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar” ose “SHPK”.

2. Ortaku i shoqërisë

Ortakë të shoqërisë janë: **Z. Kostandin Jano**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 02.06.1989, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës nr.BD9315004, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe **Z. Dhimitri Jano** i datëlindjes 20.04.1993, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës nr.BD786569, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

3. Objekti i veprimtarisë

Shoqëria funksionon si shoqëri tip group, duke mbajtur pjesëmarrje të drejtpërdrejta ose indirekt në kapitalin aksionar të shoqërive tregtare, brenda dhe jashtë vendit. Kjo i mundëson shoqërisë të koordinojë, organizojë, kontrollojë dhe menaxhojë shoqëritë nën saj në aspekte ligjore, teknike, administrative, financiare, të marketingut dhe strukturore.

Megjithatë, statusi si shoqëri tip group nuk e pengon shoqërinë nga kryerja e aktiviteteve të lejuara nga legjislacioni shqiptar, duke përfshirë projektimin, ndërtimin, supervizimin, si dhe import-export të lidhur me fushën e aktivitetit tregtar të saj.

Me specifikisht, objekti i veprimtarisë do të jetë:

- Investimi në pasuri të paluajtshme dhe në asete të tjera të prekshme apo të paprekshme;
- Investimi në instrumenta financiar (të cilët përfshijnë pa kufizime titujt e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërive tregtare (aksione ose kuota), titujt e borxhit publik apo privat, aksione ose kuotat në fonde investimesh etj);
- Ofrimi i shërbimeve manaxheriale, këshillimore në arkitekturë, financë, teknologji, strategji biznesi dhe zhvillim tregjesh.
- Ofrimi i konsulences ne lemin e ndertimit, projekteve zhvillimore dhe infrastrukturore ne Republiken e Shqiperise dhe jashte saj.

Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

4. Selia e shoqërisë

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Rruga Ismail Qemali, Apartamenti 3, Zona Kadastrale 8270, Nr pasurie 2/827+1-3, Tiranë, Shqipëri.**
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

6. Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 10,000.
- Kapitali përbëhet nga 2 (dy) kuota me vlerë nominale: ALL 5,000, që zotërohet nga Z. Kostandin Jano dhe ALL 5,000 që zotërohet nga Z. Dhimitri Jano.

7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

8. Administratori

Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm. Administrator i parë i shoqërisë është: **Z. Kostandin Jano** shtetas Shqiptar, i datëlindjes 02.06.1989, mbajtës i pasaportës nr.BD9315004.



9. Likuidimi i shoqërisë

Në rast prishje të shoqërisë, likuidimi apo falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.


Datë 15.11.2023

ORTAKËT E SHOQËRISË

KOSTANDIN JANO

Handwritten signature of Kostandin Jano in blue ink, consisting of a cursive script that reads 'Kostandin Jano' followed by a large, stylized flourish.

DHIMITRI JANO

Handwritten signature of Dhimitri Jano in blue ink, consisting of a cursive script that reads 'Dhimitri Jano' followed by a large, stylized flourish.